



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 130 Prot

Tiranë, më 01.02.2022

**NJOFTIM**

**Lënda:** Shpallje për vende vakante për oficer të policisë gjyqësore.

Në zbatim të nenit 38, pika 2, gërma “dh” dhe “e”, të Ligjit nr.97/2016, “Per organizimin e funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme, dhe neneve 17 dhe 18, të Ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, Vendimit nr. 23, datë 10.06.2020 “Për miratimin e Rregullores “Për Caktimin e Rregullave për Organizimin e Procedurës së Konkurimit dhe Emërimit të Oficerëve të Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Prokurorisë””, shpall vendet vakante si më poshtë:

1. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Vlorë** 3(tre) vende.
2. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Korçë** 3(tre) vende.
3. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Fier** 3 (tre) vende
4. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Kukës** 2(dy) vend.
5. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Sarandë** 2 (dy) vend.
6. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Berat** 2 (dy) vend.
7. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Gjirokastrë** 2 (dy) vende.
8. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Pogradec** 1(një) vend.
9. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Kurbin** 1(një) vend.
10. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Lezhë** 1(një) vend
11. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Lushnje** 1(një) vend.

➤ ***Aplikantët që do të shprehin interesin duhet të dorëzojnë dokumentat e mëposhtëm;***

- a) *Kërkesën për t'u emëruar oficer i policisë gjyqësore në seksionin e Policisë Gjyqësore, ku është shpallur vendi vakant,*
- b) *Jetëshkrimin e detajuar të kandidatit,*
- c) *Kopjen e diplomës dhe listës së notave, të arsimit të lartë dhe çdo dokument që tregon plotësimin e kriterit të arsimit, sipas ligjislacionit në fuqi për arsimin e lartë,*

- d) *Librezën e punës ose çdo dokument tjetër që vërteton përvojën në punë të kandidatit si jurist në institucionet publike, private ose profesionet e lira ose në fushën e specialitetit të kërkuar ose si oficer i policisë gjyqësore në shërbimet e policisë gjyqësore. (mbi 5 vjet)*
- e) *Vlerësime të mëparshme të punës,*
- f) *Dëshmi të gjuhëve të huaja dhe dëshmi të trajnimeve që ka kryer (nëqoftë se ka),*
- g) *Dëshmi penaliteti që tregon se kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale dhe vërtetime nga gjykata dhe prokuroria që vërtetojnë se nuk është në ndjekje penale apo gjykim për kryerjen e ndonjë vepre penale.*
- h) *Dokument që vërteton se ndaj kandidatit nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore dhe se në momentin e konkurimit nuk ka filluar procedim disiplinor ndaj tij*

➤ **Konkurimi zhvillohet në dy etapa:**

Pas vlerësimit paraprak të kryer nga Sektori i Burimeve Njerëzore, kandidatët e kualifikuar, i nënshtrohen vlerësimit nëpërmjet testimit profesional. Vlerësimi i kandidatëve nëpërmjet testimit profesional kalon në tre faza nëpërmjet një procesi pikëzimi dhe përfshin:

- a) Faza e parë, vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës në punë e të trajnimeve të lidhura me fushën;
- b) Faza e dytë, Vlerësimi me shkrim ;
- c) Faza e tretë, Intervista e strukturuar me gojë

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë kërkesat sëbashku me dokumentacionin që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të përcaktuar në ligj, brenda **15 ditëve**, nga data e shpalljes së njoftimit në adresën: **Prokuroria e Përgjithshme, Rruga “Qemal Stafa” Nr. 1 Tiranë.**

**PROKURORIA E PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**

